2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019), të paraqitura pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me akt ekspertizen e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese vërtetim lëshuar nga organet vendore për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitet 2017, 2018 dhe 2019, në vendet ku ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2017, 2018 dhe 2019 sipas QKB-së.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarami të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa “a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.**

2.2.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Bashkise Finiq.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

**2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

**a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm të së njëjtës natyre në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

**ose**

**b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit;

5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
6. Faturat Tatimore për çdo situacion.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
  5. Faturat Tatimore për çdo situacion.

*Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar të paktën **350 (treqind e pesëdhjete) punonjës** për periudhën **Korrik 2018 – Korrik 2020**, e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Korrik 2018 – Korrik 2020**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2018 – Korrik 2020**, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

### **2.3.3 Për kapacitetin teknik:**

Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense disponojnë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
  1. N.P. 1 – D Punime gërmimi në tokë.
  2. N.P. 2 – D Ndërtime civile dhe industriale.
  3. N.P. 4 – C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
  4. N.P. 5 – C Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
  5. N.P. 7 – E Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

6. N.P. 9 – D Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
7. N.P. 10 – B Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike.
8. N.P. 11 - C Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, etj.
9. N.P. 12 – E Punime të inxhinierisë së mjedisit.

### ● Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

1. N.S. 1 – B Punime për prishjen e ndërtimeve.
2. N.S. 4 - D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.
3. N.S. 8 – D Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
4. N.S. 9 – D Punime strukturorë speciale.
5. N.S. 10 – E Shtresa dhe mbistruktura speciale.
6. N.S. 16 – C Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
7. N.S. 18 - C Punime topogjeodezike.
8. N.S. 19 – C Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture.
9. N.S. 20 - C Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

### sipas modelit të lëshuar nga MPPT.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin ( njehsimin ) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, siç përcaktohet tek *”Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008”*.

### 2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet

a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:

- |  |   |
|--|---|
| 1) Inxhinier Hidroteknik                   | 2 (dy)  |
| 2) Inxhinier Ndertimi                      | 1 (një)   |
| 3) Inxhinier Ndertimi, profili Strukturist | 1 (një)   |
| 4) Inxhinier Ndertimi, profili Gjeoteknik  | 1 (një)   |
| 5) Inxhinier Elektrik                      | 1 (nje)   |
| 6) Inxhinier Elektronik                    | 1 (nje), i cili duhet te jete i certifikuar Trajnim C CNA Routing - Swithcing |
| 7) Inxhinier Mekanik                       | 1 (një)   |
| 8) Inxhinier Topograf /Markshejder         | 2 (dy)  |
| 9) Inxhinier HidroGjeolog                  | 1 (një)   |
| 10) Arkitekt                               | 1 (një)   |
| 11) Inxhinier Mjedisit,<br>për             | 2 (dy), nga të cilët një të jetë me profil<br>trajtimin e ujerave.            |

*Operatori Ekonomik duhet të deklaroje me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.4, dhe punonjesit e kërkuar në pikën 2.3.2 janë të paangazhuar në kontrata të tjera.*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2019 - Korrik 2020**. Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar ( e vlefshme), Diploma, CV dhe Libreze pune.

Gjithashtu, Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si staf mbështetës: Inxhinier Hidroteknik 1 (një), Inxhinier Ndertimi profili Transport 1 (një), Inxhinier Ndertimi 2 (dy), Inxhinier Topograf 1 (një), Inxhinier Pyjesh 1 (një), 1 (një) Restaurator i pajisur me liçencë profesionale personale lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit (Restauratori është i nevojshëm pasi zona qe parashikon ndërhyrjet projekt ka pranë nje zone me vendbanime te lashta). Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit. Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë individuale pune ( e vlefshme), Diploma, CV dhe Libreze pune.

**b.** Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

Operatori/et ekonomik duhet të ketë të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, tepaktën 40(dyzete) specialiste ku nga keta te jene te paktën:

- 2 Teknik Ndertimi (vërtetuar dhe me diplome/certifikate)
- 2 Teknik Mekanik (vërtetuar dhe me diplome/ertifikate)
- 2 Teknik Elektracist (vërtetuar dhe me diplome/ertifikate)
- 6 Karpentier
- 1 Saldator
- 2 Bojaxhi
- 2 Hekurkthyes
- 1 Hidroizolues
- 3 Murator
- 19 Specialist Ndertimi (specialitete te ndryshme)

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitte perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 4 (tre) specialist per montim tubash
- 2 (dy) hidraulik
- 4 (kater) saldator

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 1(nje) prej Inxhinierëve të siperkerkuar duhet të jetë i pajisur me Certifikatë/Diplomë – Auditues energjie - “Certifikatë për auditimin e energjise”/ ”Eficenca e energjise në Ndertesa”

(Për inxhinierin e efikasitetit të energjise duhet të ketë këto dokumenta provuese: Kontrata e punës (e vlefshme), Certifikata (Dip) për efikasitetin e energjise, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

- 1(nje) prej Inxhinierëve të siperkerkuar duhet të jetë i pajisur me Certifikatë/Diplomë – specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dëshmuar me kontratë pune dhe certifikatë përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.

(Për ekspertin zjarrfikës duhen këto dokumenta provuese: Kontrata e punës (e vlefshme), Certifikata (Dip) përkatëse, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

- 1(nje) prej Inxhinierëve të siperkerkuar duhet të jetë i pajisur me Certifikatë/Diplomë – Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

(Për ekspertin e mjedisit duhen këto dokumenta provuese: Kontrata e punës (e vlefshme), Certifikata (Dip) përkatëse, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

- 2(dy) nga inxhinierët e siperkerkuar, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e Trajnimit për *”Pergjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune”*, *”Pergjegjes për sigurinë”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 2(dy) nga inxhinierët e siperkerkuar, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e Trajnimit për *”Vlerësimi dhe dokumentacioni i vlerësimit të risqeve në kantier”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 2(dy) persona duhet të jenë të certifikuar për *”Ndihmen e parë dhe ndërhyrje ndaj emergjencave”*
- 2(dy) nga inxhinierët e siperkerkuar, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e Trajnimit për *”Pergjegjes për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1(nje) nga inxhinierët e siperkerkuar, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e Trajnimit për *”Pergjegjes për mbrojtjen dhe menaxhimin e demëve në mjedis”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Për stafin e mësipërm të paraqiten: Kontratë pune ( e vlefshme) dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për periudhën 6muajt e fundit.

- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 8 (tete) specialist të certifikuar për "Punime në lartësi", të cilët duhet të figurojnë në listat e shoqërisë. Detyrimisht

te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

- c. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1 (një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ”Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e VKM 742 datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Për të cilin duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar ( e vlefshme), Diploma, Urdhër Mjeku, CV, Libreze pune sidhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhen Qershor 2019 – Qershor 2020.

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB):

- Liçencë lidhur me ndikimin në mjedis Kodi III.2.A (lëshuar nga QKL);
- Liçense e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të lëshuar nga QKL (Kodi III.2.B);
- Leje mjedisore e tipit “C” për “Magazininim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane” (lëshuar nga QKB), kodi III.1.A;
- Liçense e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për “Shpues profesionist për ujë” (lëshuar nga QKB), kodi III.7.B; Liçencë për “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat” (lëshuar nga QKL);
- Liçense e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për mbrojtjen nga zjarri të lëshuar nga QKL (Kodi 1.2.A).

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).*

**Operatori ekonomik**, nisur nga percaktimet e pikes 1 a/b të nenit 46 të ligjit 9643 “Per Prokurimin Publik”, pikes 5 të nenit 26 të VKM Nr 914 date 29.12.2014 “Cdo kriter i vecante duhet të jete ne perputhje me natyren dhe permasat e kontrates” si dhe duke pare tipologjine e zberthimit te punimeve sipas VKM 629 datë 13.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshem për zbatimin e kontratës së tenderit, në përputhje me ligjin.

Për këtë arsye duhet të paraqese:

- a) **AUTORIZIM** - “**Per perdorim civil te lendeve plasese**” lëshuar nga Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes (e vlefshme). Ky Autorizim duhet të jete lëshuar për “**Pune me lende plasese, ne sipërfaqe dhe nentoke**”, si **Subjekt i Specializuar**.

b) **Punonjës zjarrmëtar**

2 (dy)



## Dokumenta Standarde të Tenderit

(Te pajisur me deshmi për transport, ruajtjen, përdorimin dhe evidentimin e materialeve plasese dhe shperthyese).

*Ne rast se Operatori ekonomik nuk e disponon **Autorizimin** e siperkerkuar, atehere duhet te paraqese nje kontrate bashkepunimi (sherbimi / furnizimi) detyrimisht noteriale, te lidhur me nje subjekt te licensuar si me siper per kete veprimtari (e vlefshme per gjithe periudhen e prokurimit). Kontrata te shoqerohet me dokumentacionin ligjor / te vlefshem, te subjektit te kontraktuar (si me siper).*

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, me eksperience pune minimumi 10 vjete dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem: Kontratë pune e noterizuar ( e vlefshme), Diploma, CV, Libreze pune (përkatëse) sidhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhen Qershor 2019 - Qershor 2020.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **18 (tetembedhjetë)** punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet te pakten te jene 6 automakiniste, 4 buldozeriste, 8 eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 6 muajt e fundit.

5 Operatori / et ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikatën e cilësisë së punimeve:

- EN-ISO 9001 ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
- BS OHSAS 18001 / 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë).
- BS PAS 99 (Sistemi i menaxhimit të integruar).
- ISO 50001 (Sistemi i menaxhimit të energjisë).
- ISO 39001 (Certifikate për sistemin e menagjimit të sigurisë në trafikun rrugor).
- ISO EN 3834-2:2006 (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike).
- SA 8000 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore).
- ISO IEC 27001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).
- ISO 28001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit).
- ISO 1452-1 (Sistemi i tubacioneve plastike).
- DS CEN 15128 (Sistemi i standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit).
- BS EN 13331-1 2002 ( Sistemet per veshjen e kanaleve).
- ISO 3744:2010 ( Sistemet per nivelin e garantuar te fuqise se zerit).

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Dokumenta Standarde të Tenderit

6.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues min. 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues min. 15 ton	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues min. 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues 5 - 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Bitumatrice (sperkatese bitumi)	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Greider	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul gome hekur mbi 12 ton	1 Copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur hekur	2 Copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc/Autovinc	2 copë	Pronësi ose me qera
Minidamper/Damper	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozite Uji 5000 lit	2 copë	Pronësi ose me qera
Cekic pneumatik	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisja per matjen e presionit (e përbëre nga pompa automatike e presionit, sensor për matjen e temperatures, sensor për matjen e presionit, ekranin, printerin) me këto parametra: Kapaciteti i prurjes: 28 l/min – 68 l/min; Prurja e energjise elektrike: 230v - 50HZ ose 400v - 50HZ; Valvul sigurie; Presioni maksimal: 25 bar; Komandimi: automatik/manual; Memorie: 1 milion matje Temperatura e matjes: -10 deri në 45 C.	1 copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Moto/Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparat per saldimin e tubove	3 copë	Pronësi ose me qera
Aparat per ngjitje tubo	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparatura për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metode me goditje (me pjate) duhet të plotësojë këto parametra: Forca e Goditjes (ndikimit): 7070 N. Koha e Ndikimit: 17 ms. Lartësia e leshimit: 720 mm Memorie 900 matje.	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	3 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier për zyra	2 copë	Pronësi ose me qera
Tranxhe hekuri	1 copë	Pronësi ose me qera
Perzjeres llaci	1 copë	Pronësi ose me qera
Trapane	1 copë	Pronësi ose me qera
Sharre asfalti/betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara	1000 m2	Pronësi ose me qera
Fabrikë prodhim betoni dhe nyje Inertesh	1 copë	Pronësi ose me qera ose furnizimi
Fabrike Asfalto - Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera ose furnizimi
Eskavator/Vinc krah gjat mbi 30m, aftesi mbajtese mbi 40 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi Horizontale dhe me Kend	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 500 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 15 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 7 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë
- Uniforma pune 200cope
- Jelek pune 200cope
- Doreza pune 200cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 40 copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë:

a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton

## Dokumenta Standarde të Tenderit

regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikata e pronësisë së mjetit.

- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore, dhe çertifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten noteriale të qerave e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Fabrika e Betonit dhe Nyja e Inerteve duhet të jete e pajisur me Leje mjedisore Tipi B për Fabrike Betoni dhe Impjant inertesh.

Fabrika e Asfaltit duhet të jete e pajisur me Leje mjedisore e tipit B për prodhim asfalti.

- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga përfaqesuesi i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- f) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".**

Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kërkuara, në përpjestim dhe përputhje me punët e marra për sipër sipas marrëveshjes së bashkepunimit.

Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "*periudhë*" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç tënenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo *përfundimi i afatit të zbatimit të saj*, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, autorizimet/kontratat e furnizimit për materialet / pajisjet si mëposhtme:

a). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, ISO 39001 - 2012, PAS 99: 2012 dhe QKL perkatese perfshi Lejet perkatese qe duhen marre per keto impiante** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Inerte, – Betone,**

b). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, shoqeruar me certifikatat e konformitetit sipas ASTM A 615 dhe DIN 488-2** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Hekur ndertimi,**

c). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015 dhe Kataloget perkates te produkteve** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Materialet Elektrike**

d). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, dhe Kataloget perkates te produkteve** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Pllaka betoni, bordura betoni, puseta betoni, tuba betoni etj.**

e). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015,** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Materialet hidraulike - tubo, rakorderi etj.**

f). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, shoqeruar me testet e materialeve dhe certifikatat e konformitetit DIN EN 775-1, DIN EN 12020-1,-2, DIN EN 1090** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Vetratat, dritaret d/a, plastike etj**

g). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, shoqeruar me testet e materialeve dhe certifikatat e konformitetit EN 10223-3:2013 ose 2014,** shoqeruar me kataloget perkatespër prodhimin ose furnizimin/autorizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Rrjete per rrethimin, tel i zinguar/i**

## thjeshte etj

**Për plotësimin e pikave pika a, b, c, d, e, f, g operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”**

Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose angleze. Me anë të kësaj skede teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me ato të deklaruara në ofertë dhe të prodhuara nga kompani të çertifikuara sipas standardit ISO 9001:2008/2015.

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Do të organizohet një vizitë në kantier ne date 14.09.2020 ne oren 10:00 prane Autoritetit Kontraktor per te paraqitur mostrat e tubacioneve Tubo HDPE, PE100, me raport testimet perkatese, si dhe shoqeruar me Certifiaktat ISO te prodhimit, Operatori i interesuar Ekonomik Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shitesë e shpjegime ku dhe do te pajisen me vertetim nga insitucioni (mosparaqitja eshte kusht skualifikimi). Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma “a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor ( në rast të shpalljes fitues).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratroi i shoqërisë që merr përsipër me shpenzimet e veta dhe është dakort që të paraqesi pranë AK mjetet dhe pajisjet e kërkuara më sipër, në rast se do të lindi nevoja për verifikimin e tyre, përpara shpalljes së klasifikimit.

Cdo ofertues duhet te paraqese **Planorganizimin dhe Planin e Sigurise ne Kantier** per punimet ne objekt sipas VKM nr 692 date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe te ruajtjes se shendetit ne pune” i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: Bashkëngjitur

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkengjitur

Grafiku i Punimeve: 60 dite

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

bashkengjitur

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |



**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**  
**Punët – Procedura e Hapur**

**Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me

